# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449175**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Paradoksi i drejtësisë ndërkombëtare: Si mund të përfundojnë në dënime të ngjashme dy anë të kundërt a të historisë? |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/blogu-tema/paradoksi-i-drejtesise-nderkombetare-si-perfundojne-ne-denime-te-ngja-i586479` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 12:43:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 12:45:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `40390ab3ad01fe351f4715e516aded7db4c9a537c420be884067093e50f4039e` |
| TEKSTI | `5590e49dbbdaed0d2545258176482fe7c705b9e8b225f206b65d55366c1a4ab1` |
| PAMJA | `5ccdd87c2367b7f5a46f52ea2ce37f3624a88bca08d7aeb7134b894bd75f4ad0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1d503eea4d922f3bede61f63a7ed6f5c2d032ca9eaa32414c1c89dfbc2e53618` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1d503eea4d922f3bede61f63a7ed6f5c2d032ca9eaa32414c1c89dfbc2e53618`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Paradoksi i drejtësisë ndërkombëtare: Si mund të përfundojnë në dënime të ngjashme dy anë të kundërta të historisë?

TemA

16 Shtator 2026, 14:45Blog Bjorn Runa

Ajo që ishte edhe më surprizuese në lidhje me verdiktin e sotëm të Gjykatës Speciale në Hagë është tronditja dhe befasia me të cilën shumë shqiptarë e përjetuan vendimin, duke harruar se këto tribunale u krijuan posaçërisht për të hetuar dhe dënuar krime për të cilat akuzohet UÇK-ja. Për rredhojë, ishte vetëm e natyrshme që në njëfarë pike, gjykata do t'i shpallte ata fajtorë për diçka. Tek e fundit, për këtë arsye u krijua.

Nga ana tjetër, çka është vështirë të kapërdihet është shkalla e dënimit të ish-krerëve të UÇK-së. Albert Speer, ministri nazist përgjegjës për armatimet dhe mbajtjen në këmbë të ekonomisë së luftës në Gjermaninë hitleriane, u dënua në procesin e Nyrembergut me 20 vite burg. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me 25 vite burg secili. Për dy udhëheqësit e tjerë të UÇK-së, ndonëse më të ulëta, dënimet janë sërish në ato kufij.

Katër burra të cilët përfaqësojnë krejt të kundërtën e asaj çka Speer përfaqësonte në Europën e shekullit të 20-të, të pozicionuar në luftë kundër një regjimi me synime thuajse identike me atë të nazistëve dhe që ndoshta vetëm mjetet i mungonin e jo vullneti për të qenë në një nivel me ta.

Nëse 20 vite ishte dënimi që u gjykua i drejtë ndaj një prej personave që mbajtën në këmbë ekonominë naziste të luftës, si duhet ta kuptojmë kur njerëz që udhëhoqën një përpjekje për liri, marrin dënime të ngjashme, e madje edhe më të rënda?

Teksa dëgjoje qasjen e trupës gjykuese në seancën e sotme, të krijonte përshtypjen se kanë një imagjinatë fëminore rreth luftës. Përpjekjet për liri nuk janë ngjarje neutrale, ku viktima ka luksin të përllogarisë me kujdes çdo veprim të vetin. Aq më tepër në rastin e UÇK-së që, siç doli edhe nga dëshmitë e disa ish ushtarakëve të NATO-s të përfshirë në luftën e Kosovës, nuk ka qenë një organizatë me një strukturë të qartë komanduese, e aftë për të ndërmarrë veprime të organizuara e të kalkuluar me hollësi.

Çfarëdo shpjegimi ligjor që të jepet, dënime kaq të gjata për ish krerët e UÇK-së, mbeten të vështira për t'u kapërdirë moralisht dhe historikisht.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Drejtësi apo turp? Shqiptarët janë dënuar për luftën me 150 vite burgim më shumë se serbët](#)

14:20 Blog / 1 koment

[Kur agresorët serbë shkruanin dosjen në Hagë, shqiptarët flinin mbi dafina]

13:35 Blog / 9 komente

Pisa: mësuesi, nxënësi dhe inteligjenca artificiale

12:55 Blog / 1 koment

## Duhet të kishim dhe ne shqiptarët qelitë tona në Hagë

12:44 Blog

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.